

SIMBOLIKA E GËRMAVE

Fredi **BALAJ**¹

PERMBLEDHJE

Fridrih Engels ka thënë: "Një nevojë e shtyn shoqërinë shumë më përpara se sa dhjetra universitete ". Pra, nevoja e njerëzve për të komunikuar në distancë dhe përpjekjet e tyre për të shkruar, kanë filluar me përdorimin e figurave që u quajtën hieroglifë. Secila figurë (hieroglifë) përfaqësonte një gërmë të caktuar p.sh. hieroglifi egjiptian me figurën e një dore quhej..."DOR" dhe përfaqësonte gërmën "D" ...(Fig. 1). Pra, për të shkruar, njerëzve ju duhej që të vizatonin një sërë hieroglifesh të cilat lexoheshin sipas gërmave që përfaqësonin, por kjo metodë të shkruari nuk ishte praktike dhe kërkonte shumë kohë... Për këtë arsye, mendoj që, njerëzit menduan që ti thjeshtëzojnë figurat e ndryshme duke i stilizuar ato në maksimum dhe në këtë mënyrë mendoj që lindën ...gërmat.

Le ti shohim gjërat më konkretisht:

Fig. – 1 HIEROGLIFI EGJIPTIAN "DOR" I CILI PËRDOREJ NË VEND TË GËRMËS **D**



Fjalet kyç- simbolika, gërmat, hieroglifë, shkruar, vizatonin, lexoheshin, figurat.

HYRJE


Shpikja e gërmave nuk ka qenë një proces imediat por një evolucion i gjatë i cili ishte një vazhdim i daljes në dritë të simboleve, proces ky që kishte filluar kohë më parë. Studimet dëshmojnë që shkrimet e para janë ato sumere dhe datojnë rreth 4000 vite p.e.s. të pasuara nga hieroglifet egjiptiane që datojnë 3200 vite p.e.s. dhe më vonë nga alfabeti fenikas që daton në vitin 1050 p.e.s. Sipas studiuesve, nga alfabeti fenikas derivuan alfabeti grek dhe ai latin. Në këtë studim unë kam dhënë versionin tim për interpretimin e simbolikës së disa gërmave të alfabetit grek dhe atij latin. Në se kam të drejtë apo jo...këtë do ta vërtetojë koha si dhe studimet e mëvonshme...

1. SIMBOLIKA E GËRMAVE

GËRMA Φ

¹ *Inxhinier i përpunimit të vendburimeve të naftës dhe të gazit. Administrator i kompanisë dhe shtëpise botuese "Fral 2000". Piktur dhe studiues.*

Në lashtësi përdorshin veshjet prej leshi, ne fillim përdorej direkt lëkura e kafshëve, kurse më vonë filloi të përdorej vetëm leshi i cili tirrej duke u bere **fi**je që mblidhej në një bosht. Pikërisht pra, nje **fi**je e mbledhur në një bosht (siç mbahej në lashtësi dhe siç vazhdon edhe sot nëpër viset tona) mund të na cojë në një figurë, stilizimi i së cilës na çon te gërma Φ (**fi**) ashtu siç shqiptohet shkurtimisht fjala **fi**je - **fi** (Fig. 2).



FIJE => FI (Φ)

Fig. 2

GERMA Θ

Le të përfytyrojmë një fëmijë të cilit i bie pjata nga dora dhe pasi ajo **thetet** në dy pjesë fëmija thote ...e **thejta** (*geg*) dhe po t'a stilizojmë figurën e pjatës së **thejt** do të mbërrijme tek gërma Θ (**theta**), (Fig. 3) për këtë arsye mendoj se nga fjala **thejta** ka derivuar fjala **theta**... Gërma Θ (**theta**) në alfabetin pellazg jepej si në Fig. 4 , pra nje send i **thejt** në katër pjesë, gjë që na e perforcon më shumë faktin që po llogjikojmë drejt... Mendoj se edhe numri **8** (**tetë**)... (**eight** ang., **otto** ita., **octo** lat., **okto** gre., **acht** ger., etj.) ka lidhje pikërisht me atë që sapo sqaruam më lart...




Fig. 3 E THEJT => THETA (Θ)




Fig. 4 E THEJT => THETA NE ALFABETIN PELLAZG

GERMA Δ

Shkronja Δ (**delta**) mendoj se ka derivuar nga stilizimi i figurës së **deltës** se një lumi (fig. 5) ndërsa fjala **delta** mendoj se ka rrjedhur nga bashkimi i fjalëve shqipe **del tan**, pra është vendi ku **del tan** lumi dhe që në shumicën e rasteve merr formën e gërmës Δ ...



Fig. 5. DEL TAN => DELTA (Δ)

GERMA **N**

Në alfabetin e vjeter egjiptian të perëndisë THOT, hieroglifi që simbolizonte valët e ujit (/\/\/\/\/) lexohej **NUJ** ...pra **N'UJ** dhe pikërisht për këtë mendoj se elementi i parë i këtij simboli ka shërbyer për të krijuar gërmën **N** te alfabetit latin ...(fig. 6). Edhe në alfabetin e lashtë grek gërma N lexohej dhe vazhdon të lexohet NU...(N'UJ)...




Fig. 6 N'UJ => N

GERMA **M**

Si në lashtësi ashtu edhe sot **malet** janë konsideruar si vende të shenjta (Olimpi, Tomorri, Ararat, Everest, Fuji etj.). Ato kanë qenë gjithnjë prezente në jetën e njerëzve duke u admiruar gjithnjë prej tyre qoftë nga larg qoftë duke u ngjitur nëpër to...të mrekulluar...qoftë duke i kapërcyer ato për të shkuar diku larg, për të kujtuar pastaj gjithnjë me **mall** vendlindjen, qoftë edhe për të sjellë nga larg **mall** për ta këmbyer pastaj me **mallrat** vendas. **Malet** kanë shërbyer edhe si barriera natyrale që ndanin popujt nga njëri-tjetri prandaj njerëzit i admironin ato edhe si mbrojtës nga çdo e keqe (**male lat.**) Në lashtësi kuptimin e fjalës **nalt** e jepte vetëm fjala **al** dhe me kalimin e kohës, për të dhënë idenë e **naltësive**, asaj ju shtua përpara ndajfolja e vendit **ne**, ndërsa për të dhënë idenë e shumësit iu shtua prapashtesa **t** dhe kështu fjala **al** filloi të shqiptohet **n'al't...nalt**. Mendoj se fjala **mal** është formuar nga bashkimi i fjalëve **me al (m'al)** që do të thotë se kemi të bëjmë me një pjesë të tokës që është **me nalt (in alto ita.)** ndërsa në disa diekte të shqipes, shqiptohet **mol** dhe kur kemi të bëjmë me shumë **mole** themi...**a tan mol** ose **mol tan a** ...dhe meqë shpesh gërma **l** kalon në gërmën **n**, kemi **mon tan a** dhe nga kjo mendoj se kanë ardhur fjalët: **montagna** (ita.), **montaña** (spa.), **montis** (lat.), **montagne** (fre.), **mountain** (ang).

Malet shpesh shfrytëzoheshin edhe për me **vu** kufij ndarës midis komuniteteve të ndryshëm (Alpet e Italisë, Alpet e Shqipërisë, Pirenejt, Korabi etj.) pra mund të thuhet se ato (**malet**) e **vun'o** kufirin (**vuno** në greqisht do të thotë **mal**)... Duke parë shkronjën **M** sidomos në disa mbishkrime Etruske (fig. 7) vetëvetiu të shkon mendja te **mali**, pra gërma **M** mendoj se është pikërisht simboli i një **mali** (fig. 8).



Fig. 7., GERMA **M** NË AFLABETIN ETRUSK**Fig. 8.** MAL => MGERMA **F**

Me fillimin e përdorimit të zjarrit nga njerëzit, jeta e tyre ndryshoi rrënjësisht. Pishtari me **flak** (**flamma** lat., **fiamma** ita., **flame** ang., **llama** spa., **Flamme** ger., **fotia** gre., **flamme** fre., **plamya** rus., etj.) përdorej kudo për ndricim, për gatim, për luftë, etj. Për këto arsye mendoj se nga stilizimi i **flaks** së një pishtari ka derivuar shkronja **F** pra si simbol i një pishtari me **flak**...(fig. 9). Natyrisht që edhe në kohët e lashta, midis fiseve kishte mosmarrëveshje, luftra, ashtu si dhe sot. Le të përfytyrojmë grupet e njerëzve që sulmonin duke mbajtur në duar pishtarë të ndezur, pra një pishtar që **flak mur** (flakë mori) më pas u zëvendësua me një objekt të ngjashëm që më vonë u kthye në një simbol, pra me një **flamur** (**flag** ang., **flag** rus., etj) i cili duket si **flak** sepse në vetvete është një imitim i **flakës** (fig. 10).




Fig. 9. FLAK => F



Fig. 10. FLAK => FLAG (ANG.)

GERMA **E**


Meqënëse po flasim për flamurin mu kujtua PISHA FLAMUR (një monument natyror i mrekullueshëm në LLOGORA të VLORËS) e cila ka marrë formën e gërmës **E** si rezultat i **erës** së fortë e të vazhdueshme që **frin** e **lire** (**free ang.**)...pra **ajer** që **frin**, që lëviz i **lire** (**liberi lat., libero ita., libre fre., etj.**) fjalë që mendoj se kanë rrjedhur nga fjalët **ber** i **lir** pra është i **lir ber...liberi lat.** Edhe për një njeri që arratiset nga diku themi...iku **frijti**, është i **lirë** (**free ang.**)... Mendoj që edhe fjala **ajër** (**aria ita., air ang., air fre., aire spa., etj.**) ka rrjedhur nga bashkimi i fjalëve **a er** (**geg.**) sepse **ajri** që gjithnjë lëviz s'është gjë tjetër veçse **ere**...e cila në vetvete është **here** përkëdhelëse, **here** cinike, **here** fshikulluese dhe **here** shkatrrimtare ashtu siç ishte edhe hyjnesha **HERA**... Mendoj që gërma **E** ka rrjedhur nga stilizimi i figurës së një peme me degë të përkulura nga **era** figurë që na sjell ndërmend pikërisht atë **eren**. (FIG. 11).




ERA ⇒ E

Fig. 11.

Mendoj që për këto arsye, në mbishkrimet e hershme (etruske e sabine) gërmën **E** e gjejmë në këtë formë...(FIG. 12)...



GERMA E NE ALFABETIN ETRUSK



GERMA E NE ALFABETIN SABIN

Fig. 12.

GERMA D

Në disa dialekte të shqipes fjala **yll** shqiptohet **il** (qyteti i Trojës quhej edhe **ILION ...YLLI JONË**) ndërsa në disa të tjera shqiptohet **el** psh: **stella** lat., **estrella** spa...pra **est el** ose **est yll** ndërsa

në ang. bën **star** pra që **est ar** diçka që ndrin (në lashtësi me fjalën **ar** kuptohej diçka që ndrinte). Që në fillimet e njerëzimit **Dielli** është adhurar si perëndi (ka shumë figura të lashta në gur që paraqesin **Diellin**) mendoj se edhe fjala latine **Dio** ka lidhje me fjalën **Diell** si dhe me fjalën **dije**...Mendoj që fjala **DIELL** është e përbërë nga fjalët **DI** **EL** që do të thotë **YLLI** i **DITës**, ndërsa ylli që tregon se po **AFRO DITA** është pikërisht ylli i quajtur **AFRODITA** ose **AFERDITA** i cili është dhe simboli i hyjneshës me të njëjtin emër. Latinët **AFRODITES** i thoshin **VENERE** sepse ylli me këtë emër na lajmëronte se...po **VJEN E RE** dita... Mendoj që nga stilizimi i figurës së **DIELL**-it ka derivuar gërma **D** (FIG. 13). Në alfabetin e Egjiptit të lashtë ky simbol përdorej në vend të gërmës **T** e cila është shumë e afërt në shqiptim me gërmën **D** (FIG. 14). Po në alfabetin e Egjiptit të Lashtë, hieroglifi **DOR** që jepej me figurën e një **dore** (FIG. 15) përdorej në vend të gërmës **D**... Çuditërisht, përfytyrimin e gërmës **D** na e jep edhe një **delfin** në momentin që ai **del** dhe **hin** në ujë (FIG. 16)... mendoj që fjala **delfin** (**delfino** ita., **dolphin** ang., **dolphin** fre., **delfin** spa., **delphin** ger., **delfin** rus., etj.) është formuar pikërisht nga bashkimi i fjalëve **del** dhe **hin**...



DIELLI ⇨ D




Fig. 14



Fig.15


Fig. 16.

GËRMA T



HIEROGLIFI "DOR" PERDOREJ NE VEND TE GERMES "D"

Ndërsa përsa i përket gërmës **T** mendoj se ka derivuar nga stilizimi i figurës së **trupit** të njeriut



TRUPI ⇒ T

me krahët hapur (FIG. 17).

Fig. 17.

GËRMA **X**

Kur një njeri ecën (**ikën**) me nxitim, pra kur ai është një **ikës** (**iks**) mund të paraqitet si në (FIG. 18) prandaj mendoj që pikërisht nga figura e stilizuar e një **iksi**, ka derivuar shkronja **X** e cila quhet **iks** ndërsa kur ata që ikin janë shumë mund të themi: po **dalin** ose ikin **iksit** (**exit** anglisht do të thotë **dalje**)...Ndërsa vendi nga ku **hin t'ër ata** ose **...in t'r ata** quhet hyrje (**entrata** ita., **entrance** ang., **entree** fre., **entrada** spa., **Eintrag** ger., etj.)...ndërsa në gjuhën latine i thonë **ingressum** që mendoj se përbëhet nga fjalët shqipe **...hin krejt shum...**




NJERIU QE IKEN ⇒ IKS

Fig. 18.

GËRMA **λ**

Mendoj që gërma **λ** (**lambda**) është formuar si rezultat i stilizimit të figurës së asaj që quhet **lamba** (FIG. 19), ndërsa vetë fjala **lambda** mendoj se ka derivuar pikërisht nga fjala **llamba**.



LLAMBA → LAMBDA

Fig. 19.**GËRMA B**

Që në lashtësi njerëzit kanë qenë shumë të lidhur edhe me bletët dhe produktet e tyre (madje në gjuhën shqipe, **bleta** është e vetmja gjallesë jonjerëzore për të cilën përdoret folja vdes dhe jo ngordh). Figurat e bletëve, të gdhendura në gur, gjenden në shumë bazorelieve të antikitetit (FIG. 20).

Bleta, meqë nuk ndalet kurrë së **beri** punë, në antikitet konsiderohej si simbol i **operativitetit** që rrjedh nga fjala **opera** (**opera** lat., **opera** ita., **opera** fre., **opera** ang., **opera** spa., **opera** gre., **opera** rus., **oper** ger., etj.) sepse natyrisht **oper** është diçka që **o ber... oper...**

Bleta konsiderohej edhe si simbol i **bollëkut** që do të thotë se ka **boll** gjëra të mira.

Në antikitet, për të dhënë idenë e një sasive të madhe, është përdorur fjala **oll** (fjalë që është ruajtur edhe në anglishten e sotme) ndërsa në shqip është bërë **be oll** ose **b'oll** ndërsa në greqisht **polis**, pra **boll is**.

Mendoj se gërma **B** mund të ketë ardhur nga stilizimi i figurës së një **blete** (FIG. 21).

Pra, nga fjala **bleta** mund të ketë derivuar edhe emërtimi i kësaj gërme **beta** (kështu quhet në greqisht gërma **B**)... Një variant tjetër shkronja **B** mund të jetë edhe simboli i **buzëve** (FIG. 22) të cilat janë nga pjesët më të bukura të trupit njerëzor... Një tjetër opsion për germën **B** mendoj se mund të jetë edhe simboli i fundit të shpinës së njeriut (që në disa dialekte të shqipes quhet **betha**)... në greqisht gërma **B** quhet....**beta**...




Fig. 20.
Fig. 21



FIGURA TE GDHENDURA TE BLETES

Fig. 22

GERMA Z

Shkronja **Z**, mendoj se mund të ketë rrjedhur nga stilizimi i formës së tymit ose avullit që del nga diçka e nxehtë ose e **nzet** pra kur shohim diçka që nxjerr tym, themi **a** (asht) e **nzet**... ose...e **zet a** ... **zeta**...(FIG. 23). Pra, nga fjalët...e **zet a** mendoj se ka ardhur dhe emërtimi **zeta** i shkronjës **Z**...



E NZET A ⇒ **ZETA** ⇒ **Z**

Fig. 23.

Më gjerësisht, kjo temë është trajtuar në librin tim : "Simbolika e gërmave".

2. PËRFUNDIME

1. Nga ky studim rezulton se shpjegimi i simbolikës së gërmave greke ka lidhje direkte me gjuhën shqipe pra gjuha pellazge njehsohet me shqipen.
2. Rezulton gjithashtu se shpjegimi i simbolikës së gërmave latine , nje pjesë e mirë e të cilave derivojnë nga alfabeti etrusk, na çon në një lidhje direkte të gjuhës etruske me shqipen.
3. Gjithashtu mund të deduktohet edhe lidhja e gjuhës fenikase me shqipen.

3. **STUDIME MBËSHTETËSE**

Kocaqi E. Shqipja çelësi i gjuhëve indevropiane.

Kocaqi. E. Roli pellazgo-ilir në formimin e kombeve dhe gjuhëve europiane.

Guri S. Si t'rrokim greqishten, latinishten dhe anglishten me anë të gegnishtes.

Balaj F. Simbolika e gërmave.

Vlora N. Lashtësia e gjuhës shqipe.

Catapano G. Thot-i fliste shqip.

Zheji P. Roli mesianik i shqipes.

Stylos N. Etruskishte - Toskërishte.

Akademia e shkencave të Shqipërisë. Fjalor i gjuhës shqipe